



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 146, datë 30.07.2019**

### **PËR** **CAKTIMIN NË POZICION TË GJYQTARIT TË EMËRUAR Z. OLTİ SKRAME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 34, në pikat 1, 2, dhe 3 të nenit 39 dhe në nenin 41 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 66, 68, në shkronjën “b” të nenit 86, në pikën 1 të nenit 97 dhe në nenin 100 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në konsiderate të Vendimit të Këshillit nr. 133, datë 19.07.2019, “Për emërimin gjyqtar të z. Olti Skrame”, si dhe në renditjen e gjyqtarëve të emëruar në listën e të diplomuarve të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

### **VENDOSI:**

1. Gjyqtari i emëruar z. Olti Skrame caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarit, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ai.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**